# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-437825**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nis sezoni i ri në TKOB |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kulture/nis-sezoni-i-ri-ne-tkob-i585530` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 07:09:18 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 11:07:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `776a6f5cd7a25d46334868e6e20922918c190fe801dc98f6bec5c520adfdb090` |
| TEKSTI | `e28e6433edc7d483233815e7a80160e0c759acc905fa522f8640ea53ca88df38` |
| PAMJA | `acebe349ceddf6145c6337c2bf5026772d065efbc9ddf63d2c870b1140cc3e9f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `89e3b8fe734668d608d3b4a83097f21b44dba888b1b44681860b945b84b4bda2` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/89e3b8fe734668d608d3b4a83097f21b44dba888b1b44681860b945b84b4bda2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Nis sezoni i ri në TKOB

12 Shtator 2026, 13:07Kulturë TEMA

Nis sezoni i ri në TKOB

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor çeli mbrëmjen e djeshme sezonin e ri artistik me "Gala Operistike", një mbrëmje e veçantë kushtuar muzikës lirike, ku zërat, muzika dhe emocionet u ndërthurën në skenë.

Nën tingujt e repertorit operistik artistët sollën për publikun një program të pasur me kryevepra të repertorit botëror, duke shënuar nisjen e një sezoni të ri që premton të jetë i mbushur me shfaqje, koncerte dhe ngjarje të rëndësishme artistike.

"Gala Operistike" u konceptua si një përshëndetje artistike për nisjen e sezonit, duke vendosur në qendër fuqinë e zërit dhe të muzikës, përmes interpretimit të artistëve të skenës së Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Gonxhja u shpreh se "hapja e mbrëmjes gala me solistët në në zë të skenës shqiptare dhe asaj ndërkombëtare premton një sezon të mbushur me art, emocione dhe momente të paharrueshme".

Mbrëmja solli në skenë emocione të veçanta për artdashësit, ndërsa repertori operistik dhe interpretimet e artistëve krijuan një atmosferë mbresëlënëse në çeljen e sezonit të ri.

Nën drejtimin e dirigjentit Simone Di Felice, artistët sollën një mbrëmje të pasur vokale dhe skenike.

Mezzosopranoja Vikena Kamenica solli për artdashësit arien e Dalilës nga Samson dhe Dalila, sopranoja Eva Golemi interpretoi Leonorën nga Forza del Destino, së bashku me Stefan Po.

Një moment i veçantë i mbrëmjes ishte edhe rikthimi i baritonit Armando Likaj me arien e Figaros nga "Dasma e Figaros", pas rreth 12 vitesh. Publiku duartrokiti gjithashtu kuartetin e famshëm të "Rigolettos".

Sezoni i ri artistik i TKOBAP pritet të vijojë me një program të larmishëm, që përfshin opera, balet, koncerte dhe aktivitete të tjera, duke synuar të pasurojë jetën kulturore dhe artistike në vend.

Përmes këtij sezoni, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor synon të vijojë misionin e tij në promovimin e artit skenik, ruajtjen e repertorit klasik dhe prezantimin e krijimtarisë artistike para publikut shqiptar. A.K./TemA

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Rikthehet në Pogradec Festivali i Monodramës “Albamono”

09:04 Kulturë

Dea e Butrintit kthehet në Shqipëri

21:10 Kulturë / 3 komente

DEBATI/ Frederik Ndoci: Ja pse diktatura nxori artistë dhe prodhoi filma më të mirë

17:22 Kulturë / 8 komente

Fillon së shpejti Java Kulturore e Turqisë

15:21 Kulturë

Nis fushata e regjistrimit të artizanëve

13:18 Kulturë

Pikaso

12:14 Kulturë / 1 koment

Më 23 shtator, në Tiranë hapet ekspozita kushtuar piktorit Ibrahim Kodra

11:16 Kulturë

Çelet edicioni i XIX-të i Festivalit Folklorik Tipologjik Kombëtar të Këngës Popullore Qytetare në Elbasan

09:15 Kulturë / 1 koment

VIDEO/ Alfabeti për shkrimin e shqipes dhe lidhjet me Kishën Ortodokse, studiuesi Yll Rugova shpjegon çfarë tregojnë dokumentet për Dhaskal Todhrin

17:55 Kulturë / 8 komente

Kujtesa e numrave

17:17 Kulturë / 2 komente

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**PROFIL: Kush është ministri i ri i Brendshëm?**

10:40 Kronika / 74 komente

**Genti Tare: SPAK bëri show me Igli Taren, e mbajti 6 orë ...**

10:50 Politika / 52 komente

**PISA, hakmarrja europiane për mësueso-fobët shqiptarë**

16:18 Politika / 39 komente

**Audiopërgjimi i Ahmetajt dhe akuzat për trafik armësh, qe...**

11:15 Politika / 74 komente

**Nga ndërhyrja te Trump, te Samiti i NATO-s! Thaçi për Ram...**

11:30 Politika / 36 komente

## Blog Tema

**Haga, midis maktheve dhe paranojave**

21:25 Blog / 1 koment

**Haga, midis maktheve dhe paranojave**

21:00 Blog / 1 koment

**Parku i Liqenit me syte nga qielli dhe SPAK**

19:26 Blog / 7 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by



Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.